



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore / Regional River Basin Authority / Rajonalni
Autoritet Rijecnog Sliva

RAPORT PËR IDENTIFIKIMIN E SEGMENTEVE
LUMORE PËR PASTRIM

Pellgu Lumor i Ibrit

Gusht, 2025

Përmbajtja

1.	Hyrje	5
1.1.	Pellgu Lumor Ibër	5
2.	Vlerësimi i Gjendjes në Teren.....	6
2.1.	Komuna Fushë Kosovë.....	7
2.2.	Komuna Mitrovicë e Jugut.....	13
2.3.	Komuna Drenas	17
2.4.	Komuna Lipjan	20
2.5.	Komuna Podujevë.....	23
2.6.	Komuna Graçanicë.....	25
2.7.	Komuna Obiliq	28
2.8.	Komuna Vushtrri.....	32
2.9.	Komuna Prishtinë	33
2.10.	Komuna Zubin Potok	37
3.	Përfundim	40

Lista e figurave:

Figura 1.	Zonat e rrezikuara nga vërshimet - Fushë Kosovë.....	8
Figura 2.	Segmenti i lumit Graçanka - Fushë Kosovë.....	9
Figura 3.	Segmenti i lumit Drenica - Fushë Kosovë	10
Figura 4.	Segmenti i lumit Sitnica - Fushë Kosovë	11
Figura 5.	Segmenti i lumit Prishtevka - Fushë Kosovë	12
Figura 6.	Kanali i Lumit Lushta - Mitrovicë Jugore.....	14
Figura 7.	Segmenti i lumit Ibër - Mitrovicë Jugore	15
Figura 8.	Segmenti i lumit Ibër - Mitrovicë Jugore	16
Figura 9.	Segmenti Kizhnarekë - Komoran, Drenas	18
Figura 10.	Segmenti Nekoc – Komoran, Drenas.....	19
Figura 11.	Segmenti Krajkovë - Shtrubullojë, Drenas	20
Figura 12.	Ujërrjedhat lumore të komunës së Lipjanit për pastrim	22
Figura 13.	Segmenti i lumit Llap – Podujevë	24

Figura 14. Segmenti i lumit Dumnica - Podujevë	25
Figura 15. Segmenti i lumit Graçanka - Graçanicë	26
Figura 16. Segmenti i lumit Prishtevka - Graçanicë	27
Figura 17. Segmenti i lumit Sitnica – Graçanicë	27
Figura 18. Segmenti i Lumit Sitnica - Obiliq	29
Figura 19. Segmenti i lumit Llap - Obiliq	30
Figura 20. Segmenti i lumit Drenica - Obiliq	31
Figura 21. Segmenti i lumit Sitnica – Vushtrri	32
Figura 22. Segmenti i lumit Graçanka – Prishtinë	34
Figura 23. Segmenti i lumit Prishtevka – Prishtinë	34
Figura 24. Segmenti i lumit Sojevë – Prishtinë	35
Figura 25. Segmenti i lumit Sojevë – Prishtinë	36
Figura 26. Segmenti i lumit Llap – Prishtinë	36
Figura 27. Segmenti i lumit Ibër - Zubin Potok	38
Figura 28. Segmenti i lumit Ibër - Zubin Potok	39
Figura 29. Segmentet lumore për pastrim - Pellgu Lumor Ibër	46
Figura 30. Segmentet lumore të nevojshme për pastrim për vitin 2025 - Pellgu Lumor Ibër	50

Lista e fotove:

Foto 1. Gjendja e lumit Graçanka - Fushë Kosovë	9
Foto 2. Gjendja e lumit Drenica - Fushë Kosovë	10
Foto 3. Gjendja e lumit Sitnica - Fushë Kosovë	11
Foto 4. Gjendja e lumit Prishtevka - Fushë Kosovë	12
Foto 5. Kanali i Lumit Lushta - Mitrovicë Jugore	14
Foto 6. Gjendja e lumit Ibër - Mitrovicë Jugore	15
Foto 7. Gjendja e lumit Ibër - Mitrovicë Jugore	16
Foto 8. Gjendja e lumit Kizhnarekë - Komoran, Drenas	17
Foto 9. Gjendja e lumit Nekoc – Komoran	18
Foto 10. Gjendja e lumit Krajkovë - Shtrubullojë, Drenas	19
Foto 11. Gjendja e lumit Sitnica – Lipjan	22
Foto 12. Gjendja e lumit Llap - Podujevë	24
Foto 13. Gjendja e lumit Graçanka - Graçanicë	26
Foto 14. Gjendja e lumit Drenica – Obiliq	31

Lista e tabelave:

Tabela 1. Segmentet lumore për pastrim - Fushë Kosovë	8
Tabela 2. Segmentet lumore për pastrim - Mitrovicë Jugore	13
Tabela 3. Segmentet lumore për pastrim - Drenas	17
Tabela 4. Segmentet lumore për pastrim - Lipjan	21
Tabela 5. Segmentet lumore për pastrim - Podujevë	23
Tabela 6. Segmentet lumore për pastrim - Graçanicë	25
Tabela 7. Segmentet lumore për pastrim - Obiliq	28
Tabela 8. Segmentet lumore për pastrim - Vushtrri	32
Tabela 9. Segmentet lumore për pastrim - Prishtinë	33
Tabela 10. Segmentet lumore për pastrim - Zubin Potok	37
Tabela 11. Totali i segmenteve lumore për pastrim për komunat e Pellgut Lumor Ibër	42
Tabela 12. Segmentet lumore të nevojshme për pastrim për vitin 2025 - Pellgu Lumor Ibër	47
Tabela 13. Segmentet prioritare të propozuara për pastrim për vitin 2025	49

1. Hyrje

Pellgu Lumor i Ibrit është një ndër pellgjet më të rëndësishme ujore në territorin e Republikës së Kosovës, i cila përfshin gjithsej 15 komuna. Ky pellg përbën një tërësi burimi të ujit për përdorim shtëpiak, bujqësor, industrial dhe rekreativ për ruajtjen e biodiversitetit natyror.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të adresojë nevojën për identifikimin dhe ndërhyrjen në segmentet e lumenjve që paraqesin ndotje apo rrezik mjedisor në kuadër të Pellgut Lumor të Ibrit. Në këtë drejtim, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të lumenjve, duke përfshirë mbledhjen sistematike të të dhënave nga komunat përkatëse përmes një forme të unifikuar.

Ky raport ka një sërë objektivash specifike që ndihmojnë në realizimin e një vlerësimi të saktë dhe të qëndrueshëm të nevojave për pastrim në segmentet lumore të Pellgut të Ibrit. Një ndër objektivat kryesore është hartimi i një liste të detajuar dhe të besueshme të segmenteve kritike që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për pastrim, bazuar në të dhënat e mbledhura nga terreni.

Gjithashtu, një komponent kyç i procesit është bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë me zyrtarët komunalë në secilën nga komunat përkatëse, për të siguruar që informacioni i mbledhur të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër, sigurohet edhe mbledhja e koordinatave të sakta gjeografike për secilin segment të identifikuar, gjë që ndihmon në përgatitjen e hartave dhe planifikimin efikas të ndërhyrjeve.

Për hartimin e këtij raporti është ndjekur një qasje e strukturuar dhe e koordinuar me akterët lokalë të përfshirë në menaxhimin e resurseve ujore në kuadër të Pellgut Lumor të Ibrit. Këto informacione janë të domosdoshme për të kuptuar nivelin e ndikimit dhe për të ndihmuar në vendimmarrjen mbi prioritetet e ndërhyrjes.

Së fundmi, raporti synon të realizojë edhe një proces të qartë prioritizimi të segmenteve në bazë të shkallës së ndotjes, rrezikut për komunitetin dhe urgjencës së nevojës për ndërhyrje, me qëllim që resurset të shfrytëzohen në mënyrën më të efektshme të mundshme, ku gjatë vlerësimeve dhe inspektimeve të fundit, është evidentuar një nevojë e shtuar për ndërhyrje në segmente të caktuara të lumenjve brenda këtij pellgu, për shkak të akumulimit të mbeturinave, bllokimit të rrjedhës, apo ndikimit negativ mbi komunitetet përreth.

1.1. Pellgu Lumor Ibër

Pellgu Lumor i Ibrit është një nga katër pellgjet kryesore ujore në territorin e Republikës së Kosovës dhe përbën një nënpellg të rëndësishëm të Pellgut Ndërkufitar të Lumit Danub

(PLD), i cili derdhet në Detin e Zi. Ky pellg shtrihet në pjesën qendrore dhe veriore të vendit, përkatësisht në rajonin e Drenicës dhe në Luginën e Kosovës, duke mbuluar një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 4,044 km², që përbën rreth 37% të territorit të përgjithshëm të Kosovës.

Lumi Ibër, lumi kryesor i këtij pellgu, buron nga gjashtë burime në lindje të Malit të Zi dhe rrjedh përmes territorit të Malit të Zi dhe Serbisë, për të hyrë në Kosovë afër vendbanimit të Banjës. Më pas rrjedh drejt juglindjes, kalon nëpër qytetin e Mitrovicës dhe vijon rrjedhën e tij drejt veriut, duke përshkuar komunat Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Në afërsi të Rudnicës, pranë maleve të Kopaonikut, lumi largohet nga territori i Kosovës dhe kalon sërish në Serbi, ku bashkohet me Moravën Perëndimore dhe më pas me Danubin.

Nga një gjatësi totale prej mbi 270 kilometrash, rreth 90 kilometra ndodhen brenda territorit të Kosovës. Gjatë këtij shtrirjeje, lumi dhe rrjeti i tij hidrografik shërben si një burim jetik për rreth 1.053.000 banorë, duke plotësuar nevojat për ujë të popullsisë, bujqësisë, industrisë dhe të ekosistemeve natyrore.

Pellgu i Ibrit përfshin një rrjet të gjerë të degëve të lumenjve të cilët kontribuojnë në rrjedhën kryesore dhe ndihmojnë në formësimin e këtij sistemi hidrologjik. Ndër më të rëndësishmit janë Lumi Sitnica dhe Lumi Llapi, si dhe shumë të tjerë si Lumi i Drenicës, Lumi Prishtevka, Lumi Bistrica, Lumi Dubnica, Lumi i Janjevcës, Lumi i Sojevës, Lumi i Gadimes, Lumi Lushta, Lumi Verbica, Lumi i Smrekovicës, Lumi Topilla, Gracanka, Lumi Tërstena, dhe Lumi i Vuqës, së bashku me degët e tyre përkatëse.

Po ashtu, në këtë rrjet përfshihet edhe Lumi i Barës, një ndër degët që ndikon në sistemin e ujërave sipërfaqësore dhe që kontribuon në gjendjen mjedisore dhe ekologjike të pellgut.

Pellgu Lumor i Ibrit përfshin gjithsej 15 komuna në territorin e Republikës së Kosovës:

Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas, Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Podujevë, Lipjan, Ferizaj, Obiliq, Shtime, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Graçanicë.

Për shkak të rëndësisë së lartë hidrologjike, ekologjike dhe socio-ekonomike që ka ky pellg, është thelbësore që të monitorohet dhe të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme. Ky raport ka për qëllim të identifikojë segmentet lumore të ndotura dhe të propozojë masa konkrete për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse dhe institucionet përgjegjëse në nivel qendror.

2. Vlerësimi i Gjendjes në Teren

Ky kapitull paraqet një vlerësim fillestar të gjendjes së segmenteve lumore në kuadër të komunave që përfshihen në Pellgun Lumor të Ibrit. Të dhënat janë mbledhur në bashkëpunim me zyrtarët komunalë përkatës përmes inspektimeve në terren dhe formateve

të standardizuara të raportimit. Vlerësimi përqendrohet në identifikimin e segmenteve me nivel të lartë të ndotjes ose bllokimeve fizike, duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike, ndikimin në mjedis, rrezikun për komunitetin dhe urgjencën për ndërhyrje. Komunitatet e mëposhtme përfaqësojnë zonat kryesore ku është evidentuar nevoja për pastrim dhe ndërhyrje mjedisore.

2.1. Komuna Fushë Kosovë

Territori i komunës së Fushë Kosovës, bazuar në bazën ekzistuese të të dhënave si dhe në të dhëna historike, paraqet cenueshmëri dhe rrezik serioz nga vërshimet, veçanërisht në zonat deltaike të pellgjeve lumore apo në hapësirat e rrafshëta. Këto përmblytje shkaktohen nga fryrja e lumenjve (përrenjve) dhe ngritja e nivelit të ujërave gjatë reshjeve të rrëmbyeshme, si dhe punët e kryera me infrastrukturën mbrojtëse nuk kanë dhënë efekte të pritura, pasi rregullimi i lumenjve është bërë në mënyrë të pjesshme. Poashtu mungesa e kontrollit gjatë ndërtimit, si dhe mungesa e mirëmbajtjes pas përfundimit të punimeve, ka zvogëluar efektin e ndërhyrjeve të kryera.


Sipas të dhënave në dispozicion, territori i Komunës së Fushë Kosovës është më së shumti i rrezikuar nga vërshimet në pjesën qendrore. Vërshimet ndodhin kryesisht si rezultat i daljes nga shtrati të lumenjve Sitnicë dhe Drenicë.

Zonat më të rrezikuara janë: Henci, Miradia e Poshtme, Vragolia, Fushë Kosova, Kuzmini dhe Lismiri.

Sektorët më të prekur janë:

- ✓ Sektori nga Graboci i Poshtëm deri në bashkimin e lumit Drenicë me lumin Sitnicë në Vragoli, ku janë të rrezikuara vendbanimet Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomazotin, Bardh i Vogël, Kuzmin, Sllatinë e Vogël dhe Vragoli. Në këtë sektor rrezikohen gjithashtu rruga rajonale Sllatinë – Drenas dhe hekurudha Fushë Kosovë – Drenas.
- ✓ Sektori nga kufiri administrativ me Komunën e Lipjanit (në jug) deri te kufiri me Komunën e Obiliqit (në veri), ku nga të dy krahët e lumit Sitnicë rrezikohen fshatrat Miradi e Poshtme, Henc, Kuzmin, Lismir dhe lagjet e qytetit: Bresje dhe Nakaradë.

Harta në vijim pasqyron zonat potenciale të përmblytjeve në territorin administrativ të Komunës së Fushë Kosovës.


Figura 1. Zonat e rrezikuara nga vërshimet - Fushë Kosovë¹

Komuna e Fushë Kosovës ka propozuar gjithsej katër segmente lumore që kërkojnë pastrim, duke përfshirë lumenj me ndikim të drejtpërdrejtë në zonat urbane dhe bujqësore. Ndër to, segmentet përgjatë lumit Drenica dhe lumit Graçanka janë vlerësuar nga komuna si me prioritet të lartë për ndërhyrje, për shkak të ndotjes së shtuar dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe popullatë.

Tabela 1. Segmentet lumore për pastrim - Fushë Kosovë²

N r.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Graçanka (me prioritet)	Latitude 42.613814 Longitude 21.067084	Latitude 42.5949228 Longitude 21.1041178	5.1 km	Fshatrat: Miradi e Epërme Miradi e Poshtme
2	Drenica (me prioritet)	Latitude 42.6516164 Longitude 21.001589	Latitude 42.6158193 Longitude 21.0688362	10.4 km	Fshatrat: Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomazotin, Bardh i Vogël, Vragoli, Kuzmin
3	Sitnica	Latitude 42.5954378 Longitude 21.0590914	Latitude 42.65168 Longitude 21.07482	7.64 km	Fshatrat: Miradi e Poshtme, Henc, Vragoli, Kuzmin, Lismir, Nakaradë, Lagjet 028 dhe 029 (F.Kosovë)
4	Prishtevka	Latitude 42.62604 Longitude 21.09882	Latitude 42.62399 Longitude 21.0711	2.53 km	Lagjia e Bresjes (F.Kosovë)

¹ Të dhëna zyrtare nga komuna e Fushë Kosovës

² Të propozuara nga komuna e Fushë Kosovës



Figura 2. Segmenti i lumit Graçanka - Fushë Kosovë

Segmenti i lumit Graçanka i propozuar për pastrim duke shtrirë një gjatësi prej rreth 5.1 km, përshkon zonën ndërmjet fshatrave Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme, dhe për shkak të ndotjes së lartë dhe ndikimit në tokat bujqësore dhe komunitetin lokal, është vlerësuar si segment me prioritet të lartë për ndërhyrje nga ana e komunës së Fushë Kosovës.



Foto 1. Gjendja e lumit Graçanka - Fushë Kosovë




Figura 3. Segmenti i lumit Drenica - Fushë Kosovë

Segmenti i lumit Drenica, i propozuar si me prioritet të lartë për pastrim, me një gjatësi prej rreth 10.4 km, përshkon një territor të gjerë që përfshin fshatrat Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomazotin, Bardh i Vogël, Vragoli dhe Kuzmin, zona këto me dendësi të lartë banimi dhe aktivitete bujqësore. Natyra e ndotjes dhe ndikimi potencial në cilësinë e jetës dhe mjedisin përreth e bëjnë këtë segment një ndër zonat më kritike që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme në komunën e Fushë Kosovës.



Foto 2. Gjendja e lumit Drenica - Fushë Kosovë




Figura 4. Segmenti i lumit Sitnica - Fushë Kosovë

Segmenti i lumit Sitnica, i identifikuar si problematik për shkak të vërshimeve të shpeshta dhe rrezikut nga përmytjet, me një gjatësi prej rreth 7.64 km, përfshin një zonë me rëndësi të lartë sociale dhe ekonomike, duke kaluar përmes fshatrave Miradi e Poshtme, Henc, Vragoli, Kuzmin, Lismir, Nakaradë, si dhe lagjet 028 dhe 029 të komunës së Fushë Kosovës. Për shkak të rrezikut të vazhdueshëm nga përmytjet dhe dëmeve që shkaktohen në infrastrukturë, tokat bujqësore dhe banesat, ky segment përbën një zonë kritike që kërkon trajtim urgjent në kuadër të planit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrjedhave lumore.



Foto 3. Gjendja e lumit Sitnica - Fushë Kosovë



Figura 5. Segmenti i lumit Prishtevka - Fushë Kosovë

Segmenti i lumit Prishtevka me një gjatësi prej rreth 2.53 km, kalon përmes Lagjes së Bresjes në komunën e Fushë Kosovës, një zonë e ndjeshme urbane që përballlet shpesh me vërshime dhe përmytje gjatë reshjeve intensive. Për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të banorëve, infrastrukturën rrugore dhe objektet përreth, pastrimi dhe mirëmbajtja e këtij segmenti paraqet një nevojë të domosdoshme për të parandaluar dëmet mjedisore dhe ekonomike në të ardhmen.



Foto 4. Gjendja e lumit Prishtevka - Fushë Kosovë

2.2. Komuna Mitrovicë e Jugut

Në kuadër të procesit të mbledhjes së të dhënave për gjendjen e segmenteve lumore në territorin e saj, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka identifikuar dy segmente që paraqesin nevojë të qartë për pastrim dhe ndërhyrje. Këto përfshijnë një segment të lumit Ibër, i cili përbën rrjedhën kryesore që kalon përmes qytetit, si dhe kanalën e lumit Lushta, një degë e rëndësishme që ndikon drejtpërdrejt në mjedisin urban dhe zonat e banuara.

Të dy këto segmente përbëjnë elemente të rëndësishme të infrastrukturës ujore të qytetit dhe ndikojnë në menaxhimin e ujërave të rrjedhshme, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi. Sipas vlerësimit të komunës, pastrimi i këtyre segmenteve është i domosdoshëm për të parandaluar grumbullimin e mbeturinave, përmirësimin e rrjedhjes së ujit dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet apo degradimi mjedisor.

Tabela më poshtë tregon segmentet e propozuara nga komuna për pastrim:

Tabela 2. Segmentet lumore për pastrim - Mitrovicë Jugore³

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Kanali i Lumit Lushta	Latitude: 42.88208 Longitude: 20.8664603	Latitude: 42.8932427 Longitude: 20.8721152	1.51 km	Përfshinë një pjesë të madhe të zones urbane që rrezikon ekonominë familjare, bizneset etj
2	Lumi Ibër	Latitude: 42.89133 Longitude: 20.86624	Latitude: 42.90286 Longitude: 20.86779	1.92 km	Përfshinë një pjesë të madhe të zones urbane që rrezikon ekonominë familjare, bizneset etj
3	Ibër	Latitude: 42.88324 Longitude: 20.79497	Latitude: 42.86755 Longitude: 20.81965	3.49 km	Ka nevojë për pastrim nga vegjetacioni dhe nga mbeturinat e ngurta si dhe thellim të shtratit të lumit. Rrezikohen ekonomi familjare, biznese dhe toka bujqesore

³ Të propozuar nga komuna e Mitrovicës Jugore



Figura 6. Kanali i Lumit Lushta - Mitrovicë Jugore

Kanali i lumit Lushta në Mitrovicën e Jugut, me një gjatësi prej rreth 1.51 km, përfshin një pjesë të konsiderueshme të zonës urbane të qytetit. Ky segment kalon përmes një zone me densitet të lartë të banorëve dhe ndërtesave, duke përfshirë një numër të madh të ekonomive familjare, bizneseve dhe infrastrukturës lokale. Si rrjedhojë, bllokimi i këtij kanali paraqet një rrezik të shtuar për vërshime, ndotje dhe dëmtime të mundshme të pronës publike dhe private.

Sipas komunës, ky kanal nuk është pastruar prej më shumë se 20 vitesh, gjë që ka çuar në grumbullimin e mbeturinave, depozitimin e materialeve të ngurta dhe ngadalësimin e rrjedhjes së ujit. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes mjedisore dhe sociale në këtë pjesë të qytetit.



Foto 5. Kanali i Lumit Lushta - Mitrovicë Jugore




Figura 7. Segmenti i lumit Ibër - Mitrovicë Jugore

Segmenti i lumit Ibër, me gjatësi prej 3.49 km, paraqet nevojën për pastrim nga vegjetacioni i tepërt dhe mbeturinat e ngurta, si dhe thellim të shtratit të lumit për të rritur kapacitetin e rrjedhjes.



Foto 6. Gjendja e lumit Ibër - Mitrovicë Jugore



Figura 8. Segmenti i lumit Ibër - Mitrovicë Jugore

Segmenti i lumit Ibër i identifikuar për pastrim nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, me një gjatësi prej rreth 1.92 km, përfshin një pjesë strategjike të rrjedhës së lumit në zonën urbane të qytetit, duke kaluar pranë hapësirave të banuara dhe infrastrukturës publike. Për shkak të pozicionit të tij qendror dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me rrugë, ura dhe hapësira të frekuentuara nga qytetarët, mbajtja e këtij segmenti të pastër është jetike për mbarrëvajtjen ekologjike dhe pamjen urbane të qytetit.

Ndotja e vazhdueshme dhe grumbullimi i mbeturinave përgjatë këtij seksioni përbëjnë rrezik për mjedisin dhe mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, veçanërisht gjatë reshjeve intensive kur ka rrezik më të shtuar për bllokim dhe përmytje. Pastrimi i këtij segmenti është thelbësor jo vetëm për funksionin hidrologjik të lumit, por edhe për aspektin estetik dhe shëndetin publik të zonës urbane përreth.



Foto 7. Gjendja e lumit Ibër - Mitrovicë Jugore

2.3. Komuna Drenas

Komuna e Drenasit ka identifikuar tre segmente lumore me nevojë të theksuar për pastrim, të cilat shtrihen në zonat Kizhnarekë–Komoran, Nekoc–Komoran dhe Krajkovë–Shtrubullovë. Të gjitha këto segmente janë të prekura nga vërshimet sezonale, të cilat shkaktojnë dëme të konsiderueshme në tokat bujqësore dhe pronat përreth. Për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë në sektorin bujqësor dhe komunitetet lokale, këto segmente përfaqësojnë një prioritet të lartë për ndërhyrje në kuadër të planit të pastrimit të lumenjve në Pellgun Lumor të Ibrit.

Tabela 3. Segmentet lumore për pastrim - Drenas⁴

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Kizhnarekë - Komoran	Y-7491246.569, X-4712832.175	Y-7492426.877, X-4713445.180	1352 m	Vërshim, Dëme në bujqësi
2	Nekoc - Komoran	Y-7491344.879, X-4710992.866	Y-7492570.307, X-4712701.872	2212 m	Vërshim, Dëme në bujqësi
3	Krajkovë - Shtrubullovë	Y- 7488745.926, X-4718678.384	Y- 7490887.362, X-4719029.423	2254 m	Vërshim, Dëme në bujqësi

Segmenti lumor Kizhnarekë – Komoran, me gjatësi prej 1352 metrash, ndodhet në një zonë të ndjeshme bujqësore dhe ka qenë subjekt i vërshimeve të përsëritura, të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në të mbjellat dhe tokat bujqësore përreth. Grumbullimi i mbeturinave, depozitimi i sedimenteve dhe mungesa e pastrimit të rregullt kanë përkeqësuar gjendjen e shtratit të lumit, duke rritur rrezikun për përmbytje të mëtejshme. Për pasojë, ky segment është vlerësuar si me prioritet të lartë për ndërhyrje, me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe reduktimin e rrezikut për komunitetin lokal.



Foto 8. Gjendja e lumit Kizhnarekë - Komoran, Drenas

⁴ Të propozuar nga komuna e Drenasit



Figura 9. Segmenti Kishnarekë - Komoran, Drenas

Segmenti Nekoc – Komoran, me gjatësi prej 2212 metrash, përshkon një zonë të gjerë me karakter bujqësor, e cila është vazhdimisht e ekspozuar ndaj vërshimeve, veçanërisht gjatë sezonit të reshjeve të dendura. Si pasojë e kapacitetit të pamjaftueshëm të rrjedhës dhe mungesës së pastrimit të vazhdueshëm, janë raportuar dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore dhe infrastrukturën përreth. Për këtë arsye, ky segment është identifikuar si një ndër zonat me rrezik të lartë mjedisor dhe ekonomik, dhe konsiderohet prioritar për pastrim dhe rehabilitim të rrjedhës lumore në kuadër të planit të ndërhyrjeve për Pellgun Lumor të Ibrit.



Foto 9. Gjendja e lumit Nekoc – Komoran



Figura 10. Segmenti Nekoc – Komoran, Drenas

Segmenti lumor Krajkovë – Shtrubullojë, me gjatësi prej 2254 metrash, shtrihet nëpër një zonë bujqësore me rëndësi të veçantë për komunitetin lokal, por është i prekshëm nga vërshimet sezonale, të cilat kanë shkaktuar dëme të përsëritura në sipërfaqe të mbjella dhe tokë punuese. Rrjedha është karakterizuar nga depozitime të shumta mbetjesh dhe materialesh inerte që kanë ulur kapacitetin e përçimit të ujit, duke rritur ndjeshëm rrezikun për përmbytje. Për këtë arsye, segmenti është vlerësuar si kritik për ndërhyrje të shpejtë, me qëllim mbrojtjen e resurseve bujqësore dhe lehtësimin e rrjedhës natyrore të lumit në këtë zonë.



Foto 10. Gjendja e lumit Krajkovë - Shtrubullojë, Drenas



Figura 11. Segmenti Krajkovë - Shtrubullovë, Drenas

2.4. Komuna Lipjan

Komuna e Lipjanit ka evidentuar një numër të konsiderueshëm segmentesh lumore dhe rrjedhjesh të përkohshme që paraqesin rrezik të lartë për vërshime dhe përmbytje, si pasojë e grumbullimit të bimësisë, mbeturinave dhe materialeve që pengojnë rrjedhën natyrore të ujit. Segmentet e raportuara përfshijnë pjesë të lumit Sitnica, si dhe degë të tij të rëndësishme si Lumi i Gadimes, Lumi Zhegovcit, Lumi Janjevka, Përroi i Manastirit (Smallusha), Vërsheci, Nerodimja, dhe rrjedhje të përkohshme në zonat Magurë, Akllap, Grackë dhe Topliqan.

Sipas të dhënave, këto segmente përbëjnë një gjatësi të përgjithshme prej mbi 100 km, ku ndotja, ngushtimi i shtratit dhe mungesa e pastrimit kanë rritur ndjeshëm rrezikun për përmbytje në zona të banuara dhe bujqësore. Prandaj, ato janë vlerësuar si prioritare për ndërhyrje, me qëllim mbrojtjen e komunitetit dhe reduktimin e rrezikut nga dëmet mjedisore dhe ekonomike.

Tabela 4. Segmentet lumore për pastrim - Lipjan⁵

Nr.	Segmenti I Lumit	Koordinatat e Fillimit të Segmentit		Koordinatat e Mbarimit të Segmentit		Gajtësia e Nevojshme për Pastrim Gjatësia (m)	Arsyeja/Banorët Zona të prekura
		X	Y	X	Y		
1	Sitnica	4702389.209	7511304.489	4702389.209	7511304.489	14169.65	Rrezik për vërshime, përmblytje, zona të grumbulluara me bimësi, mbeturina etj që pengojnë rrjedhjen ujore, rrezik për vërshim afër shtëpive të banuara.
2	Rrjedhje e Përkohëshme (Degë e Lumit Sitnica)	4706187.889	7505167.961	4713557.743	7504752.528	9798.59	
3	Përroi i Manasrit (Smallusha)	4708127.683	7520192.718	4706322.846	7510365.608	12617.53	
4	Lumi Zhegovcit	4708938.924	7513510.623	4707090.931	7510048.296	5336.56	
5	Lumi Janjevka	4710818.848	7512172.857	4709313.612	7508347.9	4300.94	
6	Lumi Zhegovcit	4708602.321	7520405.257	4709910.318	7516102.753	5041.09	
7	Lumi Janjevka	4715158.148	7520639.874	4712701.6	7517883.641	4078.88	
8	Vërshet	4708879.802	7500400.464	4713270.948	7504793.939	9231.2	
9	Lumi i Gadimes	4704880.806	7519698.623	4702924.049	7511167.121	10851.92	
10	"Magure" - Rrjedhje e Përkohëshme	4711021.991	7501358.803	4713207.253	7502629.049	3802.22	
11	"Akllap"- Rrjedhje e Përkohëshme	4713014.047	7522645.276	4711699.231	7518028.286	6632.48	
12	Nerodime	4702323.393	7513145.539	4702728.348	7511211.566	2722.47	
13	"Grackë"	4703382.68	7508071.125	4704282.978	7508678.475	1263.83	
14	"Topliqan"	4704050.482	7507466.602	4705566.985	7510450.341	4575.00	
15	Lumi Drenica	4705252.563	7495610.205	4709861.57	7493457.747	5907.78	
					Gjithsej	100330.2057	

⁵ Të propozuar nga komuna e Lipjanit



Foto 11. Gjendja e lumit Sitnica – Lipjan

Lumi Sitnica në territorin e Komunës së Lipjanit vërehet një gjendje e rënduar mjedisore për shkak të grumbullimit të mbeturinave plastike, vegetacionit të pakontrolluar dhe materialeve të tjera të ngurta. Kjo pamje reflekton situatën e ngjashme edhe në segmente të tjera lumore brenda komunës, të cilat janë të mbingarkuara me ndotje dhe pengesa natyrore që bllokojnë rrjedhën e ujit dhe rrisin rrezikun për vërshime, sidomos në afërsi të zonave të banuara. Gjendja e tillë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për pastrim dhe rehabilitim të shtratit të lumenjve në këtë komunë.




Figura 12. Ujërrjedhat lumore të komunës së Lipjanit për pastrim

2.5. Komuna Podujevë

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën veriore të Pellgut Lumor të Ibrit dhe përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Lumi Llapi dhe degët e tij. Kjo komunë karakterizohet me zonë kryesisht rurale dhe bujqësore, ku lumenjtë luajnë një rol të rëndësishëm në ujitje dhe ekosistem lokal. Megjithatë, në disa segmente është evidentuar prani e mbeturinave, vegjetacion i dendur dhe rrjedhje të ngadalësuar, që paraqesin rrezik për vërshime dhe ndotje mjedisore, veçanërisht në afërsi të zonave të banuara. Për këtë arsye, disa prej segmenteve të lumenjve në këtë komunë janë propozuar për pastrim dhe rehabilitim

Tabela 5. Segmentet lumore për pastrim - Podujevë⁶

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Llap	Latitude: 42.88875 Longitude: 21.19167	Latitude: 42.83404 Longitude: 21.17957	8.57 km	Përfshinë një pjesë të madhe të fshatit Breznicë e eperme, Gllamnik dhe Sibovc i eperm që rrezikon ekonomitë familjare, dhe tokat bujqësore
2	Dumnica	Latitude: 42.89594 Longitude: 21.21811	Latitude: 42.82697 Longitude: 21.18111	1.92 km	Përfshinë një pjesë të lagjes Kuvajti, fshatin Sfeqel, Sibovc i poshtem deri të fshati Llugë që rrezikon ekonomitë familjare, bizneset etj

⁶ Segmenti 1 i propozuar nga komuna e Podujeves, segmenti 2 nga ARPL




Figura 13. Segmenti i lumit Llap – Podujevë




Foto 12. Gjendja e lumit Llap - Podujevë

Segmenti lumor i Lumit Llapi, me gjatësi prej 8.57 kilometrash, përfshin një zonë të gjerë që kalon nëpër fshatrat Breznicë e Epërme, Gllamnik dhe Sibovc i Epërm, përshkon territore me shtrirje të konsiderueshme bujqësore dhe zona të banuara, ku rreziku nga vërshimet dhe bllokimi i rrjedhës së lumit paraqet një kërcënim për ekonominë familjare, infrastrukturën lokale dhe tokat e punueshme. Mungesa e mirëmbajtjes së rregullt ka sjellë grumbullim të mbeturinave dhe bimësisë, duke e bërë këtë segment një prioritet për ndërhyrje në kuadër të pastrimit të lumenjve në Komunën e Podujevës.




Figura 14. Segmenti i lumit Dumnica - Podujevë

Segmenti i lumit Dumnica, me gjatësi prej 1.92 kilometrash, duke përfshirë zonat e lagjes Kuvajti, fshatin Sfeqel, Sibovcin e Poshtëm deri te fshati Llugë. Ky segment ndodhet në një zonë me dendësi të konsiderueshme banimi dhe zhvillim të aktiviteteve bujqësore dhe afariste, ku ndotja dhe pengesat në rrjedhën natyrore të ujit përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për ekonominë familjare, bizneset dhe tokat bujqësore.

2.6. Komuna Graçanicë

Komuna e Graçanicës, ashtu si komunat tjera të përfshira në Pellgun Lumor të Ibrit, përballlet me probleme të theksuara të ndotjes në lumëenjë, sidomos gjatë periudhave me reshje intensive. Kjo komunë përshkohet nga Lumi Graçanka dhe një pjesë e Lumit Prishtevka, të cilët janë të ekspozuar ndaj ndotjes, grumbullimit të mbeturinave, vegjetacionit të dendur dhe daljes nga shtrati. Këto rrjedha përbëjnë rrezik për tokat bujqësore, zonat e banuara dhe infrastrukturën lokale, veçanërisht në lagjet dhe fshatrat përreth. Situata është përkeqësuar nga mungesa e pastrimeve të rregullta dhe zhvillimi urban pa planifikim adekuat pranë lumenjve. Për rrjedhojë, ndërhyrja për pastrim dhe menaxhim të qëndrueshëm të këtyre lumenjve është e domosdoshme, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit lokal.

Tabela 6. Segmentet lumore për pastrim - Graçanicë⁷

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Graçanka	Latitude: 42.59972 Longitude: 21.18882	Latitude: 42.59492 Longitude: 21.10411	9.23 km	Vershon fshatin Llapnasellë dhe Preoc, bizneset dhe tokat bujqësore

⁷ Në koordinim me komunën e Graçanicës

2	Prishtevka	Latitude: 42.63722 Longitude: 21.13026	Latitude: 42.62604 Longitude: 21.09882	3.16 km	Vershon fshatin Uglarë, tokat bujqësore, bizneset
3	Sitnica	Latitude: 42.54691 Longitude: 21.08007	Latitude: 42.59541 Longitude: 21.05909	7.03 km	Vershon fshatin Skullan, Lepi dhe Batushë



Figura 15. Segmenti i lumit Graçanka - Graçanicë




Foto 13. Gjendja e lumit Graçanka - Graçanicë

Segmenti i Lumit Graçanka, me gjatësi prej 9.23 kilometrash, shtrihet përmes fshatrave Llapnasellë dhe Preoc të kësaj komune, ku ndikimi i tij është i ndjeshëm mbi bizneset lokale dhe tokat bujqësore. Për shkak të rrjedhës së ngarkuar me mbetje, materiale të ngurta dhe vegjetacion të dendur, ky segment ka treguar prirje për vërshime të shpeshta, të cilat kërcënojnë drejtpërdrejt infrastrukturën dhe ekonominë familjare në zonë.



Figura 16. Segmenti i lumit Prishtevka - Graçanicë

Segmenti i Lumit Prishtevka, me gjatësi prej 3.16 kilometrash, shtrihet nëpër fshatin Uglarë në Komunën e Graçanicës, duke ndikuar drejtpërdrejt në tokat bujqësore dhe aktivitetet ekonomike të zonës, përfshirë edhe bizneset lokale.




Figura 17. Segmenti i lumit Sitnica – Graçanicë

Segmenti i Lumit Sitnica, me gjatësi prej 7.03 kilometrash, shtrihet nga zonat e fshatrave Skullan, Lepi dhe Batushë në territorin e Komunës së Fushë Kosovës. Ky segment ndodhet në një zonë kryesisht bujqësore, ku lumi për shkak të grumbullimit të mbetjeve, vegetacionit të dendur dhe rrjedhës së ngadalësuar, ka prirje të lartë për dalje nga shtrati

dhe përmbytje sezonale. Vërshimet në këtë pjesë dëmtojnë tokat bujqësore, infrastrukturën lokale dhe ekonominë familjare, duke e renditur këtë segment si prioritar për pastrim dhe mirëmbajtje sistematike.

2.7. Komuna Obiliq

Komuna e Obiliqit përballlet me një situatë të rënduar hidrologjike, veçanërisht përgjatë Pellgut të Lumit Sitnica, i cili mbledh shumicën e rrjedhave nga të dy anët e territorit. Lumi Sitnica, me rrjedhje fushore dhe shtrat të gjerë e të cekët, gjatë reshjeve dhe shkrirjes së borës shkakton vërshime të rënda, duke përmbytur tokat bujqësore dhe zonat e banuara, si në fshatrat Dardhishtë, Palaj, Plemetin dhe lagjen Hashanët në Obiliq. Probleme të ngjashme janë evidentuar edhe në Lumin Llap dhe Lumin Drenica, ku përmbytjet kanë prekur jo vetëm tokat bujqësore, por edhe objekte banimi e komerciale, si në fshatrat Raskovë, Milloshevë, Babimost dhe Graboc i Epërm. Po ashtu, rrjedhat malore me karakter rrëkesh përbëjnë një burim të vazhdueshëm rreziku për vërshime, duke dëmtuar zonat rurale të komunës.

Tabela 7. Segmentet lumore për pastrim - Obiliq⁸

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Sitnica	42.65168, 21.07482	42.7122, 21.02874	9.29 km	Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi Sitnica del jashtë shtratit dhe përmbyt sipërfaqe të tokave punuese për rreth, duke i shkakuar dëme të mëdha bujqësisë. Gjatë periudhave të vërshimeve, rrjedhja e lumit arrin gjersin deri 1000 m në zonat e vërshimeve duke mbuluar teritor nga fshati Dardhishtë, Obiliqin nën hekurudhë (Lagja e Hashanve), Objektet e TC B, fshatin Palaj deri në fshatin Plemetin, Vërshimet ndodhin çdo vit ku janë të rrezikuara jo vetëm tokat bujqësore por edhe objekte e banimit.
2	Llap	42.73141, 21.10025	42.73428, 21.06311	4.52 km	Lumi del nga shtrati duke përmbytur zona nga ura e Milloshevës deri në Babimost, duke dëmtuar objekte komerciale dhe disa shtëpi banimi.
3	Drenica	42.67438, 20.96216	42.65161, 21.00158	4.69 km	Për shkak të reshurave të fundit atmosferike edhe Lumi Drenica ka dal nga shtarti duke përfshir shumë toka punuese, gjersia e vërshimeve ishte në disa vende arrin në 50-100m. Problematike paraqiten rrjedhat malore me karakter rrëkesh (prrockat, projet) etj të cilat për shkak të konfiguracionit të relievit, kanë karakter vërshues duke

⁸ Të propozuara nga komuna e Obiliqit

					shkaktuar dëme nëpër disa fshatra te Komunes
--	--	--	--	--	--




Figura 18. Segmenti i Lumit Sitnica - Obiliq

Segmenti i Lumit Sitnica, me gjatësi prej 9.29 kilometrash, përfshin një zonë të gjerë të Komunës së Obiliqit. Ky segment është veçanërisht problematik gjatë prurjeve të mëdha të ujit, ku lumi del nga shtrati dhe përmyt sipërfaqe të mëdha të tokave punuese, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme bujqësisë dhe infrastrukturës lokale. Gjatë vërshimeve, rrjedha e lumit zgjerohet deri në 1000 metra gjerësi, duke përfshirë territorin nga fshati Dardhishtë, lagjen e Hashanëve në Obiliq, objektet e TC B-së, fshatin Palaj deri në Plemetin. Përmytjet ndodhin çdo vit, duke rrezikuar jo vetëm tokat bujqësore, por edhe objekte banimi dhe komerciale, çka e bën këtë segment një ndër më kritikët për ndërhyrje të menjëhershme në pastrim dhe menaxhim të rrjedhës.



Figura 19. Segmenti i lumit Llap - Obiliq

Segmenti i Lumit Llap, me gjatësi prej 4.52 kilometrash, përfshin një zonë kritike të Komunës së Obiliqit. Ky segment ka pësuar dalje të përsëritura nga shtrati, duke përmbytur tokat bujqësore në të dy anët e lumit dhe duke shkaktuar dëme të drejtpërdrejta në objekte banimi dhe komerciale. Gjendja më e vështirë është regjistruar nga ura e Milloshevës deri në hyrje të fshatit Babimost, ku janë prekur objekte si restoranti Amazona, hapësirat ndihmëse pranë tij, zona përreth një hoteli dhe minimarketi “Lili”, si dhe disa shtëpi banimi. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për pastrim dhe sistemim, për të parandaluar përmbytjet e mëtejme dhe për të mbrojtur pronën dhe jetën e banorëve.




Figura 20. Segmenti i lumit Drenica - Obiliq

Segmenti i Lumit Drenica, me gjatësi prej 4.69 kilometrash, ndodhet brenda territorit të Komunës së Obiliqit. Pas reshjeve të fundit atmosferike, ky segment ka shfaqur dalje nga shtrati, duke përmbytur tokat bujqësore përreth dhe shkaktuar dëme të konsiderueshme. Në disa pjesë, gjerësia e përmbytjeve ka arritur deri në 50–100 metra, duke vënë në rrezik jo vetëm sipërfaqet kultivuese, por edhe infrastrukturën rurale. Gjendja është përkeqësuar edhe më tej nga rrjedhat malore me karakter rrëqesh (përrenj dhe përroje), të cilat për shkak të relievit të thepisur dhe të pandërtuar, kanë një karakter vërshues, duke shkaktuar dëme të dukshme në disa fshatra të komunës. Segmenti kërkon vlerësim teknik dhe ndërhyrje të shpejtë për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të situatës.



Foto 14. Gjendja e lumit Drenica – Obiliq

2.8. Komuna Vushtrri

Komuna e Vushtrrisë përballlet me sfida të vazhdueshme në menaxhimin e burimeve ujore, sidomos në segmentet lumore që kalojnë përmes territorit të saj. Gjendja aktuale karakterizohet nga probleme të theksuara me vërshime sezonale, të cilat shkaktohen si pasojë e bllokimeve në shtratin e lumenjve, kryesisht nga vegjetacioni i dendur, grumbullimi i mbeturinave urbane dhe shkarkimet e ujërave të zeza pa trajtim. Këto kushte e bëjnë rrjedhën të pamjaftueshme për të përballuar prurjet e mëdha gjatë reshjeve, duke rritur rrezikun për përmytje të tokave bujqësore dhe zonave të banuara.

Megjithatë, në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është realizuar përkrahja për pastrimin dhe sistemimin e një segmenti të rëndësishëm të lumit Sitnica, duke përmirësuar ndjeshëm gjendjen në atë pjesë të territorit. Ky shembull i mirë tregon nevojën për vazhdimin e këtyre ndërhyrjeve edhe në pjesët tjera të rrjedhave, për të garantuar mbrojtje më të mirë të mjedisit dhe komuniteteve lokale në Vushtrri.

Tabela 8. Segmentet lumore për pastrim - Vushtrri⁹

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Sitnica	Y-7500257.402, X-4736788.707	Y-7502365.672, X-4730290.724	10600 m	Bllokim nga vegjetacioni, vërshim në fshatin Pestova




Figura 21. Segmenti i lumit Sitnica – Vushtrri

⁹ Propozuar nga komuna e Vushtrrisë

Segmenti i Lumit Sitnica, duke kaluar përmes territorit të Komunës së Vushtrrisë, konkretisht në afërsi të fshatit Pestovë. Ky segment paraqet probleme serioze për shkak të bllokimit nga vegjetacioni i dendur dhe mungesës së mirëmbajtjes, gjë që ka shkaktuar vërshime të përsëritura, duke rrezikuar tokat bujqësore dhe zonat përreth. Ndërhyrja për pastrim të shtratit është e domosdoshme për të parandaluar dëme të mëtejshme dhe për të siguruar rrjedhshmëri normale të ujit.

2.9. Komuna Prishtinë

Komuna e Prishtinës, si zonë urbane dhe me zhvillim të lartë, përballet me sfida të shumta mjedisore që lidhen me rrjedhat ujore, veçanërisht ato që kalojnë nëpër dhe rreth qytetit, si lumi Prishtevka dhe degët e tij. Problemet më të theksuara përfshijnë shkarkimet e ujërave të zeza, mbeturinat urbane, si dhe bllokimet e shtratit të lumenjve nga vegjetacioni i pakontrolluar, që ndikojnë negativisht në rrjedhjen natyrore të ujit dhe rrisin rrezikun për vërshime, veçanërisht në zonat periferike dhe fshatrat e komunës. Gjendja kërkon ndërhyrje të koordinuara për pastrim dhe menaxhim të qëndrueshëm të rrjedhave, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe sigurisë për komunitetin lokal.

Tabela 9. Segmentet lumore për pastrim - Prishtinë¹⁰

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Gračanka	42.62684 21.17968	42.61788 21.16767	1.54 km	Pastrimi, zgjerimi dhe thellimi i prrockës së ujërave në fshatin “Hajvali” në lagjen “Byqmeti” nga rruga “Pavarësia”- “Ulëzat” “Shemsedin Vllasaliu” - rruga magjistrale Prishtinë - Gjilan
2	Prishtevka	42.68706, 21.29848	42.68327, 21.17499	13.6 km	Pastrimi i shtratit të Lumit nga “Fusha e Pajtimt” përgjatë rrugës “Hasan Remniku”, fshatit “Llukar” deri në dalje të Fshatit “Makovc”
3	Sojevë	42.73527, 21.21109	42.70851, 21.15852	5.73 km	Prrocka në fshatin “Bërnice e Epërme”, shtrirja edhe në hapësira private
4	Sojevë	42.70841, 21.15685	42.71263, 21.1212	4 km	Pastrim i urave në prrockën e fshatit “Bërnice e Ulët”
5	Llap	42.7765, 21.14482	42.73142, 21.10026	8.23 km	Pastrimi i shtratit të lumit Llap, zgjerimi, thellimi dhe ndërtimi i shtratit të lumit në territorin e Komunës së Prishtinës (nga kufiri kadastral Komunës së Podujevas e deri në kufiri i Komunës së Kastriotit) si dhe lokacione tjera.

¹⁰ Propozuar nga komuna e Prishtinës dhe përpunuar nga ARPL



Figura 22. Segmenti i lumit Graçanka – Prishtinë

Segmenti i lumit Graçanka, me gjatësi prej 1.54 km, duke kaluar nëpër fshatin Hajvali, konkretisht në lagjen Byqmeti, përgjatë rrugëve “Pavarësia”, “Ulëzat”, “Shemsedin Vllasaliu” dhe deri te magjistralla Prishtinë–Gjilan. Ky segment kërkon pastrim, zgjerim dhe thellim të prrockës së ujërave, për shkak të rrezikut të bllokimit dhe vërshimeve në një zonë me dendësi të lartë banimi dhe infrastrukturë rrugore.




Figura 23. Segmenti i lumit Prishtevka – Prishtinë

Segmenti i lumit Prishtevka, me gjatësi prej 13.6 km, duke përfshirë zonën nga “Fusha e Pajtimit”, përgjatë rrugës “Hasan Remniku”, nëpër fshatin Llukar dhe deri në dalje të fshatit Makovc. Ky segment ka nevojë për pastrim të shtratit të lumit, për shkak të grumbullimit të mbeturinave dhe vegjetacionit që pengojnë rrjedhën, duke rritur rrezikun për përmbytje dhe ndotje mjedisore në zonat përreth.




Figura 24. Segmenti i lumit Sojevë – Prishtinë

Segmenti i prockës në fshatin Sojevë, me gjatësi prej 5.73 km, duke përfshirë zonën e fshatit Bërrnicë e Epërme. Ky segment kalon edhe përmes hapësirave private, gjë që e bën menaxhimin e rrjedhës më kompleks. Procka paraqet nevojë për pastrim dhe sistemim të shtratit, për shkak të rrezikut nga përmbytjet dhe bllokimet që ndikojnë negativisht në mjedisin dhe pronat private përreth.



Figura 25. Segmenti i lumit Sojevë – Prishtinë

Segmenti i prrockës në fshatin Sojevë, me gjatësi prej 4 km, duke kaluar nëpër fshatin Bërnice e Ulët. Në këtë pjesë, gjendja është rënduar veçanërisht në afërsi të urave, ku grumbullimi i mbeturinave dhe vegjetacionit pengon rrjedhën e ujit. Segmenti kërkon pastrim të urave dhe rregullim të qarkullimit ujqor, për të parandaluar përmbytjet lokale dhe dëmtimet në infrastrukturën përreth.




Figura 26. Segmenti i lumit Llap – Prishtinë

Segmenti i lumit Llap, me gjatësi prej 8.23 km, duke kaluar në territorin e Komunës së Prishtinës, nga kufiri kadastral me Komunën e Podujevës deri te kufiri me Komunën e Kastriotit. Ky segment paraqet nevojë për pastrim, zgjerim dhe thellim të shtratit të lumit, si dhe ndërtim të shtratit në disa pjesë specifike, për të siguruar rrjedhje stabile dhe për të parandaluar përmbytjet, erosioni dhe dëmtimet në zonat përreth. Ndërhyrjet janë të domosdoshme për të përmirësuar kapacitetin hidraulik të lumit dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e objekteve në këtë pjesë të komunës.

2.10. Komuna Zubin Potok

Komuna e Zubin Potokut shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës dhe përfshin një territor kryesisht malor, me ujërrjedha të shumta që derdhen në lumin Ibër dhe liqenin e Gazivodës. Për shkak të relievit të thyer dhe prurjeve të ujit gjatë periudhave me reshje intensive, disa segmente lumore paraqesin rrezik për bllokime nga vegetacioni, depozitimi i mbeturinave dhe sedimentet, duke ndikuar në rrjedhën natyrore të ujit. Problematike mbeten edhe disa rrjedha të vogla malore me karakter rrëkesh, të cilat në periudha të reshjeve të mëdha shkaktojnë erosion dhe dëme në tokat bujqësore si dhe rrezik për infrastrukturën lokale. Më poshtë në tabelë janë paraqitur dy segmente të lumin Ibër e cila ka nevojë për pastrim nga vegetacioni, mbeturinat e ngurta dhe thellim të shtratit të lumit.

Tabela 10. Segmentet lumore për pastrim - Zubin Potok¹¹

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Ibër	Latitude: 42.92793 Longitude: 20.68268	Latitude: 42.90476 Longitude: 20.73796	6.45 km	Përfshinë zonën kadastrale të Zubin Potokut, Varagë dhe Jagnjenicë
2	Ibër	Latitude: 42.90419 Longitude: 20.73847	Latitude: 42.88326 Longitude: 20.79492	6.24 km	Përfshinë zonën kadastrale Çabër, Zupq dhe një pjesë të Koshtovës në Mitrovicë Jugore

¹¹ Propozuar nga ARPL



Figura 27. Segmenti i lumit Ibër - Zubin Potok

Segmenti i lumit Ibër me gjatësi 6.45 km, përfshin zonën kadastrale të Zubin Potokut, si dhe fshatrat Varagë dhe Jagnjenicë. Ky segment ka nevojë për pastrim nga vegjetacioni i dendur dhe mbeturinat e ngurta, të cilat pengojnë rrjedhën natyrore të ujit dhe rrisin rrezikun për përmbytje të tokave bujqësore, ekonomive familjare dhe infrastrukturës lokale gjatë prurjeve të larta.



Figura 28. Segmenti i lumit Ibër - Zubin Potok

Segmenti i lumit Ibër me gjatësi 6.24 km, përfshin zonën kadastrale të Çabrit, Zupqit dhe një pjese të Koshtovës në territorin e Mitrovicës së Jugut. Ky segment paraqet nevojë për pastrim të shtratit nga vegjetacioni dhe mbeturinat e ngurta, me qëllim parandalimin e bllokimeve të rrjedhës dhe zvogëlimin e rrezikut për përmbytje të tokave bujqësore dhe pronave private.

3. Përfundim

Ky raport përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve ujore në kuadër të Pellgut Lumor të Ibrit dhe ofron një bazë të fortë për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve konkrete për pastrimin e segmenteve lumore me ndotje të theksuar. Procesi i mbledhjes së të dhënave në terren, në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse, ka mundësuar krijimin e një panorame të qartë mbi zonat më të prekura, duke përfshirë komunitetet e rrezikuara, bizneset lokale, zonat bujqësore dhe mjedisin natyror.

Gjithsej nëntë komuna (Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Drenas, Lipjan, Podujevë, Graçanicë, Obiliq, Vushtrri dhe Prishtinë) kanë evidentuar segmente specifike lumore që paraqesin rrezik të lartë për ndotje, përmytje apo bllokim të rrjedhave, si pasojë e grumbullimit të mbeturinave, vegjetacionit të pakontrolluar, ndërtimeve pa leje dhe mungesës së mirëmbajtjes.

Në Fushë Kosovë u identifikuan katër segmente të rëndësishme (Graçanka, Drenica, Sitnica dhe Prishtevka) me rrezik të lartë për komunitetet urbane dhe bujqësore.

Mitrovica e Jugut evidentoi segmentet urbane të Lumit Ibër dhe kanalit të Lumit Lushta me ndikim të drejtpërdrejtë në zonat me densitet të lartë banimi.

Drenasi propozoi tri segmente në zonat Kizhnarekë – Komoran, Nekoc – Komoran dhe Krajkovë – Shtrubullovë, të prekura nga vërshime sezonale dhe dëme në bujqësi.

Lipjani paraqiti një listë të gjerë prej mbi 100 km rrjedha për pastrim, përfshirë Lumit Sitnica dhe degët e tij, si Gadimes, Zhegovcit dhe përroin e Manastirit.

Në Podujevë, segmentet e lumenjve Llap dhe Dumnica kalojnë përmes zonave bujqësore e të banuara që përballen me rrjedhje të ngadalësuar dhe rrezik për përmytje.

Graçanica propozoi pastrimin e lumenjve Graçanka, Prishtevka dhe Sitnica, që përshkojnë zona me ndikim të ndjeshëm në ekonomi lokale dhe mjedis.

Obiliqi theksoi urgjencën për pastrim të lumenjve Sitnica, Llap dhe Drenica, të cilët, për shkak të terrenit të sheshtë dhe ndotjes së vazhdueshme, shkaktojnë përmytje të përsëritura.

Vushtrria paraqiti nevojën për ndërhyrje në lumin Sitnica në zonën e fshatit Pestovë, ku rrjedha është bllokuar nga vegjetacioni dhe mbeturinat.

Prishtina, përveç segmentit të Graçankës në lagjen Hajvali, ka propozuar edhe pastrimin e lumenjve Prishtevka, Sojevë dhe Llap në territorin e saj.

Ndërsa në Zubin Potok është e nevojshme që në lumin Ibër të pastrohen dy segmente afër njëra tjetrës.

Totali i segmenteve lumore për nga gjatësia për pastrim të marra nga tereni në Pellgun Ibër, janë 243.468 km.

Rezultatet e këtij raporti nuk duhet të shihen vetëm si një përmbledhje e gjendjes ekzistuese, por edhe si një thirrje për veprim të koordinuar dhe të menjëhershëm.

Përmirësimi i gjendjes së lumenjve nuk është vetëm një çështje mjedisore, por edhe një faktor i rëndësishëm për shëndetin publik, zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës në komunitetet përreth.

Raporti gjithashtu vendos një bazë për zhvillimin e strategjive afatgjata për mirëmbajtjen e rrjedhave ujore, përmes një qasjeje të integruar që përfshin:

- ✓ ndërhyrje teknike dhe sistematike për pastrim dhe rehabilitim;
- ✓ përmirësimin e infrastrukturës mjedisore;
- ✓ forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional; si dhe
- ✓ përfshirjen e komunitetit në ruajtjen dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

Zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti do të kontribuojë në një mjedis më të sigurt, më të pastër dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët që jetojnë dhe veprojnë në kuadër të Pellgut Lumor Ibër.

Tabela 11. Totali i segmenteve lumore për pastrim për komunat e Pellgut Lumor Ibër

Fushë Kosovë					
Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim / km	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Gračanka (me prioritet)	42.613814 21.067084	42.5949228 21.1041178	5.1	Fshatrat: Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme
2	Drenica (me prioritet)	42.6516164 21.001589	42.6158193 21.0688362	10.4	Fshatrat: Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomazotin, Bardh i Vogël, Vragoli, Kuzmin
3	Sitnica	42.5954378 21.0590914	42.65168 21.07482	7.64	Fshatrat: Miradi e Poshtme, Henc, Vragoli, Kuzmin, Lismir, Nakaradë, Lagjet 028 dhe 029 (F.Kosovë)
4	Prishtevka	42.62604 21.09882	42.62399 21.0711	2.53	Lagjia e Bresjes (F.Kosovë)
Totali				25.67	
Mitrovicë Jugore					
1	Kanali i Lumit Lushta	42.88208 20.8664603	42.8932427 20.8721152	1.51	Përfshinë një pjesë të madhe të zones urbane që rrezikon ekonominë familjare, bizneset etj
2	Lumi Ibër	42.89133 20.86624	42.90286 20.86779	1.92	Përfshinë një pjesë të madhe të zones urbane që rrezikon ekonominë familjare, bizneset etj
3	Ibër	42.88324 20.79497	42.86755 20.81965	3.49	Ka nevojë për pastrim nga vegjetacioni dhe nga mbeturinat e ngurta si dhe thellim të shtratit të lumit. Rrezikohen ekonomi familjare, biznese dhe toka bujqesore
Totali				6.92	
Drenas					
1	Kizhnarekë - Komoran	7491246.569, 4712832.175	7492426.877, 4713445.180	1.352	Vërshim, Dëme në bujqësi
2	Nekoc - Komoran	7491344.879, 4710992.866	7492570.307, 4712701.872	2.212	Vërshim, Dëme në bujqësi
3	Krajkovë - Shtrubullovë	7488745.926, 4718678.384	7490887.362, 4719029.423	2.254	Vërshim, Dëme në bujqësi
Totali				5.818	
Lipjan					
1	Sitnica	4702389.209 7511304.489	4702389.209 7511304.489	14.2	Rrezik për vërshime, përmytje, zona të grumbulluara me bimësi, mbeturina etj që pengojnë rrjedhjen ujore,

2	Rrjedhje e Përkohëshme (Degë e Lumit Sitnica)	4706187.889 7505167.961	4713557.743 7504752.528	9.79	rrezik për vërshim afër shtëpive të banuara.
3	Përroi i Manastrit (Smallusha)	4708127.683 7520192.718	4706322.846 7510365.608	12.67	
4	Lumi Zhegovcit	4708938.924 7513510.623	4707090.931 7510048.296	5.3	
5	Lumi Janjevka	4710818.848 7512172.857	4709313.612 7508347.9	4.3	
6	Lumi Zhegovcit	4708602.321 7520405.257	4709910.318 7516102.753	5.0	
7	Lumi Janjevka	4715158.148 7520639.874	4712701.6 7517883.641	4.07	
8	Vërshet	4708879.802 7500400.464	4713270.948 7504793.939	9.2	
9	Lumi i Gadimes	4704880.806 7519698.623	4702924.049 7511167.121	10.85	
10	"Magure" - Rrjedhje e Përkohëshme	4711021.991 7501358.803	4713207.253 7502629.049	3.8	
11	"Akllap" - Rrjedhje e Përkohëshme	4713014.047 7522645.276	4711699.231 7518028.286	6.63	
12	Nerodime	4702323.393 7513145.539	4702728.348 7511211.566	2.72	
13	"Grackë"	4703382.68 7508071.125	4704282.978 7508678.475	1.26	
14	"Topliqan"	4704050.482 7507466.602	4705566.985 7510450.341	4.57	
15	Lumi Drenica	4705252.563 7495610.205	4709861.57 7493457.747	5.9	
Totali				100.26	
Podujevë					
1	Llap	42.88875 21.19167	42.83404 21.17957	8.57	Përfshinë një pjesë të madhe të fshatit Breznicë e eperme, Gllamnik dhe Sibovc i eperm që rrezikon ekonomitë familjare, dhe tokat bujqesore

2	Dumnica	42.89594 21.21811	42.82697 21.18111	1.92	Përfshinë një pjesë te lagjes Kuvajti, fshatin Sfeqel, Sibovc i poshtem deri te fshati Llugë që rrezikon ekonomitë familjare, bizneset etj
Totali				10.49	
Graçanicë					
1	Gračanka	42.59972 21.18882	42.59492 21.10411	9.23	Vershon fshatin Llapnasellë dhe Preoc, bizneset dhe tokat bujqësore
2	Prishtevka	42.63722 21.13026	42.62604 21.09882	3.16	Vershon fshatin Uglarë, tokat bujqesore, bizneset
3	Sitnica	42.54691 21.08007	42.59541 21.05909	7.03	Vershon fshatin Skullan, Lepi dhe Batushë
Totali				19.42	
Obiliq					
1	Sitnica	42.65168, 21.07482	42.7122, 21.02874	9.29	Gjatë prurjeve të mëdha të ujit , lumi sitnica del jashtë shtratit dhe përmyt sipërfaqe të tokave punuese për rreth , duke i shkaktuar dëme të mëdha bujqësisë .Gjatë periudhave të vërshimeve , rrjedhja e lumit arrin gjersin deri 1000 m në zonat e vërshimeve duke mbuluar teritor nga fshati Dardhishte , Obiliqin nën hekurudhë (Lagjja e Hashanve), Objektet e TC B ,fshatin Palaj deri ne fshatin Plemetin , Vërshimet ndodhin çdo vit ku janë të rrezikuara jo vetëm tokat bujqësore por edhe objekte e banimit.
2	Llap	42.73141, 21.10025	42.73428, 21.06311	4.52	ky lum ka dal nga shtrati duke përmytur tokat në të dy anët e sajë, dhe ka vërshuar disa objekte te banimit si me e vështirsuar paraqite gjendja nga ura e Milloshevës deri ne hyrje te fshatit Babimost e kryesisht ne objektet komerciale si ne restaurant Amazona ku uji ka depërtura deri te objektet ndihmëse dhe afër hoteli . Si problematike paraqite edhe te minimarketi lili, ujrart kanë perfshire edhe disa shtepi banimi.
3	Drenica	42.67438, 20.96216	42.65161, 21.00158	4.69	Për shkak të reshurave të fundit atmosferike edhe Lumi Drenica ka dal nga shtarti duke përfshir shumë toka punuse ,gjersia e vërshimeve ishte në disa vende arrin në 50-100m . Problematike paraqiten rrjedhat malore me karakter rrëkesh (prrockat, prrojet) etj të cilat për shkak të konfiguracionit të relievit, kanë karakter vërshues duke shkaktuar dëme nëpër disa fshatra te Komunes
Totali				18.5	
Vushtrri					
1	Sitnica	Y- 7500257.402.	Y- 7502365.672.	10.600	Bllokim nga vegjetacioni, vershim ne fshatin Pestova

		X- 4736788.707	X- 4730290.724		
Totali				10.6	
Prishtinë					
1	Gračanka	42.62684 21.17968	42.61788 21.16767	1.54	Pastrimi, zgjerimi dhe thellimi i prrockës se ujërave në fshatin “Hajvali” në lagjen “Byqmeti” nga rruga “Pavarësia” - “Ulëzat” “Shemsedin Vllasaliu” - rruga magjistrale Prishtinë - Gjilan
2	Prishevka	42.68706, 21.29848	42.68327, 21.17499	13.6	Pastrimi i shtratit te Lumit nga “Fusha e Pajtimit” përgjatë rrugës “Hasan Remniku”, fshatit “Llukar” deri ne dalje të Fshatit “Makovc”
3	Sojevë	42.73527, 21.21109	42.70851, 21.15852	5.73	Prrocka në fshatin “Bërnice e Epërme “, shtrirja edhe në hapësira private
4	Sojevë	42.70841, 21.15685	42.71263, 21.1212	4	Pastrim i urave në prrockën e fshatit “Bërnice e Ulët”
5	Llap	42.7765, 21.14482	42.73142, 21.10026	8.23	Pastrimi i shtratit te lumit Llap, zgjerimi, thellimi dhe ndërtimi i shtratit te lumit ne territorin e Komunës se Prishtinës (nga kufiri kadastral Komunës së Podujevas e deri te kufiri i Komunës së Kastriotit) si dhe lokacione tjera.
Totali				33.1	
Zubin Potok					
1	Ibër	Latitude: 42.92793 Longitude: 20.68268	Latitude: 42.90476 Longitude: 20.73796	6.45	Përfshinë zonën kadastrale të Zubin Potokut, Varagë dhe Jagnjenicë
2	Ibër	Latitude: 42.90419 Longitude: 20.73847	Latitude: 42.88326 Longitude: 20.79492	6.24	Përfshinë zonën kadastrale Çabër, Zupq dhe një pjesë të Koshtovës në Mitrovicë Jugore
Totli				12.69	
Totali për komunat				243.468 km	




Figura 29. Segmentet lumore për pastrim - Pellgu Lumor Ibër

Bazuar në analizën e gjendjes në teren e cila pothuajse secili lum apo segment lumor përballet me bllokim nga vegjetacioni, mbeturinat e ngurta apo edhe me sedimente të ndryshme nga ujrat e zeza, më poshtë janë të paraqitur në tabelë segmentet lumore të cilat janë më prioritare për pastrim:

Tabela 12. Segmentet lumore të nevojshme për pastrim për vitin 2025 - Pellgu Lumor Ibër¹²

Fushë Kosovë				
Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim / km
1	Graçanka (me prioritet)	Latitude: 42.613814 Longitude: 21.067084	Latitude: 42.5949228 Longitude: 21.1041178	5.1
2	Drenica (me prioritet)	Latitude: 42.6516164 Longitude: 21.001589	Latitude: 42.6158193 Longitude: 21.0688362	10.4
3	Sitnica	Latitude: 42.5954378 Longitude: 21.0590914	Latitude: 42.65168 Longitude: 21.07482	7.64
4	Prishtevka	Latitude: 42.62604 Longitude: 21.09882	Latitude: 42.62399 Longitude: 21.0711	2.53
Totali				25.67
Mitrovicë Jugore				
1	Kanali i Lumit Lushta	Latitude: 42.88208 Longitude: 20.8664603	Latitude: 42.8932427 Longitude: 20.8721152	1.51
2	Lumi Ibër	Latitude: 42.89133 Longitude: 20.86624	Latitude: 42.90286 Longitude: 20.86779	1.92
Totali				3.43
Drenas				
1	Kizhnarekë - Komoran	Y-7491246.569, X-4712832.175	Y-7492426.877, X-4713445.180	1.352
2	Nekoc - Komoran	Y-7491344.879, X-4710992.866	Y-7492570.307, X-4712701.872	2.212
3	Krajkovë - Shtrubullovë	Y- 7488745.926, X-4718678.384	Y- 7490887.362, X-4719029.423	2.254
Totali				5.818
Lipjan				
1	Sitnica	4702389.209 7511304.489	4702389.209 7511304.489	14.2
2	Lumi Zhegovcit	4708938.924	4707090.931	5.3

¹² Prioritizuar nga ARPL

3	Lumi Janjevka	7513510.623 4710818.848 7512172.857	7510048.296 4709313.612 7508347.9	4.3
Totali				23.8
Podujevë				
1	Llap	Latitude: 42.88875 Longitude: 21.19167	Latitude: 42.83404 Longitude: 21.17957	8.57
2	Dumnica	Latitude: 42.89594 Longitude: 21.21811	Latitude: 42.82697 Longitude: 21.18111	1.92
Totali				10.49
Graçanicë				
1	Graçanka	Latitude: 42.59972 Longitude: 21.18882	Latitude: 42.59492 Longitude: 21.10411	9.23
2	Prishtevka	Latitude: 42.63722 Longitude: 21.13026	Latitude: 42.62604 Longitude: 21.09882	3.16
3	Sitnica	Latitude: 42.54691 Longitude: 21.08007	Latitude: 42.59541 Longitude: 21.05909	7.03
Totali				19.42
Obiliq				
1	Sitnica	42.65168, 21.07482	42.7122, 21.02874	9.29
2	Llap	42.73141, 21.10025	42.73428, 21.06311	4.52
3	Drenica	42.67438, 20.96216	42.65161, 21.00158	4.69
Totali				18.5
Vushtrri				
1	Sitnica	Y-7500257.402, X-4736788.707	Y-7502365.672, X-4730290.724	10.600
Totali				10.6
Prishtinë				
1	Prishtevka	42.68706, 21.29848	42.68327, 21.17499	13.6
2	Llap	42.7765, 21.14482	42.73142, 21.10026	8.23
Totali				21.83
Totali për komunat				139.558 km

Segmentet e prioritzuara për pastrim gjatë vitit 2025 janë përzgjedhur duke u bazuar në disa kriter kryesore: gjendja aktuale e ndotjes dhe prania e mbetjeve të grumbulluara, rëndësia e tyre për rrjedhën ujore dhe ekosistemin lokal, afërsia me zonat e banuara dhe infrastrukturën publike, si dhe rreziku i përhapjes së ndotjes në pjesë të tjera të pellgut. Gjithashtu, është marrë parasysh edhe frekuenca e përdorimit të këtyre segmenteve nga komuniteti dhe ndikimi i drejtpërdrejtë që kanë në cilësinë e ujit dhe mjedisit përreth. Përzgjedhja synon që pastrimi të ketë efekt sa më të madh në përmirësimin e cilësisë mjedisore dhe të kontribuojë në parandalimin e ndotjeve të mëtejshme.

Nga 243.468 km totale e gjatësisë së segmenteve të propozuara për pastrim nga ana e komunave, 139.558 km parashihet që janë më prioritarë për këtë vit (2025), si të nevojshme për pastrim, ndërsa gjatë viteve në vijim, varësisht nga bugjeti i ministrisë, synohet që pjesën tjetër dhe pjesë tjera që kanë nevojë për pastrim, të mbështetën nga ana e MMPHI.

Tabela 13. Segmentet prioritare të propozuara për pastrim për vitin 2025

Segmentet e propozuara për pastrim											
Komunat	Fushë Kosovë	Mitrovicë Jugore	Drenas	Lipjan	Podujevë	Graçanicë	Obiliq	Vushtrri	Prishtinë	Zubin Potok	
Gjatësia e segmentve lumore / km	25.67	6.92	5.818	100.26	10.49	19.42	18.5	10.6	33.1	12.69	243.468
Segmentet prioritare për pastrim për vitin 2025											
Komunat	Fushë Kosovë	Mitrovicë Jugore	Drenas	Lipjan	Podujevë	Graçanicë	Obiliq	Vushtrri	Prishtinë	Zubin Potok	
Gjatësia e segmentve lumore / km	25.67	3.43	5.818	23.8	10.49	19.42	18.5	10.6	21.83	0	139.558
Përqindja e segmentve lumore për pastrim	100%	50%	100%	24%	100%	100%	100%	100%	66%	0%	57%




Figura 30. Segmentet lumore të nevojshme për pastrim për vitin 2025 - Pellgu Lumor Ibër

